Në bazë të nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM-së” numër 5/02), Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e nëntëmbëdhjetë, të mbajtur më 30 janar të vitit 2014, solli

**STRATEGJIA E QYTETIT TË SHKUPIT**
**PËR TË RINJTË**
**për periudhën 2014-2018**

## 1. HYRJE

Koalicioni i organizatave rinore SEGA punon në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të politikave rinore në RM, për ti bashkuar dhe fuqizuar të rinjtë, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme të tyre.

Në periudhën e muajit nëntor të vitit 2012 – shtator të vitit 2013, Koalicioni SEGA e implementoi projektin “Krijimi i Strategjisë Lokale Rinore të Qytetit të Shkupit”, të financuar nga Qyteti i Shkupit dhe Rajoni i Normandisë së Poshtme.

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i Strategjisë Lokale Rinore 5 vjeçare (SLR) për Qytetin e Shkupit dhe Planin Aksional.

Në drejtim të krijimit të Strategjisë Lokale Rinore për Qytetin e Shkupit u realizuan aktivitetet vijuese:

- **Konferenca “Politika për të rinjtë në Qytetin e Shkupit“**

Më 22 nëntor të vitit 2012 u organizua Konferenca për krijim të politikës lokale rinore të Qytetit të Shkupit. Qëllimi i Konferencës ishte fillimi i procesit të krijimit të politikës lokale rinore të Qytetit të Shkupit dhe fitimi i informacioneve hyrëse prej palëve relevante të përfshira për nga aspekti i nevojave prioritare dhe zgjidhjeve të mundshme në fushën e politikës rinore që më pas do të shfrytëzohen gjatë përpilimit të Propozim dokumentit – Strategjia lokale rinore. Në Konferencën u prezantuan rezultatet e hulumtimeve rinore që tregojnë gjendjen kombëtare dhe politikën rinore, gjatë kësaj këto hulumtime i qasen fushave konkrete që i trajton Strategjia kombëtare për të rinjtë. Në suaza të Konferencës u realizuan 4 grupe punuese të cilat mbuluan 8 fusha që janë të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për të Rinjtë (SKR) edhe atë: Arsimi; Vetëpunësimi rinorë; Cilësia e jetës; Shëndetësia dhe parandalimi; Participimi i të rinjve; Informimi rinorë; Kultura dhe puna rinore.

- **Realizimi i anketës dhe përgatitja e analizave për qëndrimet e rinisë në Qytetin e Shkupit në lidhje me nevojat rinore.**

Me qëllim që të hulumtohen nevojat specifike të rinjve në nivel të Qytetit të Shkupit, u realizua anketimi i ekzemplarit prezantues prej 591 të rinjve prej 10 komunave në territorin e Qytetit të Shkupit. Me anketën u përfshinë të rinjtë e moshës prej 15 – 29 vjeçare, prej të gjitha bashkësive etnike në Maqedoni. Anketa përfshiu pyetjet për 8 fushat e përcaktuara sipas Strategjisë Kombëtare për të rinjtë, dhe e njëjta u realizua nga ana e të rinjve – anketues. Prej rezultateve të anketës u përpilua Analiza në lidhje me qëndrimet e të rinjve në Qytetin e Shkupit në lidhje me nevojat e tyre.

- **Konferenca “Strategjia për të rinjtë në Qytetin e Shkupit”**

Më datë 12 qershor të vitit 2013, në Sallën e Këshillit të Qytetit të Shkupit, u organizua Konferenca në temën “Strategjia për të rinjtë në Qytetin e Shkupit”. Në këtë konferencë u prezantuan rezultatet e analizës së përpiluar për qëndrimet e të rinjve nga Qyteti i Shkupit në lidhje me nevojat rinore. Pjesëmarrësit patën rastin që të japin kontribut për definimin e qëllimit

të përgjithshëm, qëllimet specifike, strategjitë dhe krijimin e Planit Aksional për vitin 2014. U formuan 8 grupe punuese në pajtim me prioritetet SKR: Arsimi; Vetëpunësimi rinorë; Cilësia e jetës; Shëndetësia dhe parandalimi; Participimi i të rinjve; Informimi rinorë; Kultura dhe puna rinore.

- **Debati publik për propozim Strategjinë për të rinjtë e Qytetit të Shkupit**

Më 8 tetor 2013 në Sallën e Këshillit të Qytetit të Shkupit u organizua debat publik për propozim Strategjinë për të rinjtë të Qytetit të Shkupit. Pjesëmarrësit e këtij evenimenti patën rastin që të japin kontribut për përmirësimin e propozim Strategjisë Lokale për të rinjtë, e Qytetit të Shkupit.

## 2. ANALIZA E GJENDJES

Me qëllim të hulumtimit të nevojave specifike të rinisë në nivel të Qytetit të Shkupit, koalicioni "TANI" realizoi anketimin e ekzemplarit reprezentues prej 591 personave të rij nga 10 komunat e territorit të Qytetit të Shkupit. Pasqyra e përgjithshme që shfaqet pas anketës së realizuar për nevojat e të rinjve dhe qëndrimet e tyre në Qytetin e Shkupit, në masë më të madhe reflekton rezultatet të cilat prej më parë janë fituar prej hulumtimeve të tjera në nivel lokal dhe kombëtarë për tematikën e njëjtë. Prapëseprapë, për shkak të specifikave të Qytetit të Shkupit si qytet më i madh dhe si kryeqytet në të cilin gravitojnë pjesa më e madhe e të rinjve në shtetin tonë, në të gjenden si institucione lokale ashtu edhe kombëtare që mund ti përmbushin nevojat e të rinjve, mund të veçohen dhe disa rekomandime me qëllim të avancimit të pozitës së popullatës së re.

Të anketuarit konsiderojnë se ekziston hapësirë për përmirësim të cilësisë së arsimit në nivel lokal, edhe pse gjatë kësaj parashtrohet pyetja për atë se sa janë kompetencat e institucioneve arsimore. Të anketuarit prononcohen se ka përmirësime në programet arsimore krahas gjendjes në të kaluarën, por prapëseprapë nevojitet përsosja e programeve përmes angazhimit të kuadrit kompetent mësimdhënës dhe përmes investimeve për furnizim më të mirë teknik të shkollave. Mësimi në praktik është një fushë në të cilën mund të intervenohet në masë të madhe, nëse merret parasysh fakti se të anketuarit konsiderojnë se praktika nuk është e mjaftueshme e as përkatëse për nevojat e të rinjve. Në këtë kontekst, institucionet lokale dhe vetëqeverisja lokale mund të kontribuojnë përmes zhvillimit të interesit të biznesit për pranim të praktikantëve dhe gjithsesi përmes subvencionimit të punës praktike përmes mbulimit të shpenzimeve themelore të praktikantëve.

Papunësia si një problem i hidhur, në masë të konsiderueshme i godet të rinjtë në Qytetin e Shkupit. Politizimi i punësimeve tret kurajën e të rinjve gjatë procesit të rregullt të gjetjes së punës, për këtë arsye ata shumë pak vizitojnë Agjencinë për punësime dhe shumë pak janë të njoftuar për mundësitë e zhvillimit të aftësive dhe punës praktike që organizohen nga Qeveria dhe Agjencia për punësim. Gjithashtu, të rinjtë pothuajse fare nuk i shfrytëzojnë programet për nxitje të vetë punësimit dhe punësimit përmes subvencionimit të bizneseve. Në nivel lokal, kompetencat në këtë fushë janë me të vërtetë të kufizuara. Një gjë e tillë mund të vërehet përmes programeve specifike në nivel lokal, të cilat në pajtim me specifikat lokale do të zhvilloheshin me qëllim të nxitjes së punësimeve. Gjendja në fushën e pjesëmarrjes rinore në proceset e sjelljes së vendimeve nuk dallohen shumë prej gjendjes së konstatuar më parë edhe gjatë hulumtimeve tjera si në nivele lokale ashtu edhe në nivel kombëtarë. Përkatësisht, të anketuarit nuk kanë përvojë që të konsultohen gjatë proceseve të sjelljes së vendimeve si nga ana e vetëqeverisjes lokale, ashtu edhe nga institucionet tjera lokale. Në disa prej komunave, ekzistojnë mekanizma të caktuara jo formale, përmes të cilave do të mund të sigurohet pjesëmarrja rinore gjatë sjelljes së vendimeve, por nevojitet që këto mekanizma të fuqizohen dhe zhvillohen. Si fakte interesante në këtë fushë, shfaqet nevoja për implementim të mekanizmit për pjesëmarrje të rinisë në shkollat, gjatë kësaj këtë qëndrim e ndajnë shumica, pa

marrë parasysh moshën. Në këtë kontekst, rekomandohet zhvillimi i mëtutjeshëm i formave ekzistuese të organizimit rinorë në shkollat, siç janë bashkësitë shkollore.

Mekanizmi rinorë, është shumë i ulët në nivel lokal. Një pjesë e vogël e të rinjve janë anëtarë në shoqatat civile dhe në partitë politike, gjithashtu, një pjesë e vogël prej tyre, kanë pasur përvojë me punën vullnetare, edhe pse marrë në përgjithësi ata përkrahi angazhimin vullnetarë. Të anketuarit, konsiderojnë se të rinjve në nivel lokal, më tepër u nevojitet angazhimi punues që të mund të aktivizohen edhe në fushat tjera. Më tepër mjete financiare do të duhej të nxitnin aktivimin rinorë dhe gjithsesi realizimin e ideve rinore në nivel lokal.

Të rinjtë, nuk janë të kënaqur prej ofertës kulturore në komunat e tyre, e as që janë të inkuadruar në përpilimin e programit për kulturë. Të anketuari, konsiderojnë se nevojitet ndarja e më shumë mjeteve financiare për përkrahje të kulturës në nivel lokal dhe gjithsesi të nxitet interesi i të rinjve që ti vizitojnë manifestimet kulturore përmes sigurimit të kushteve të volitshme për të njëjtit si një kategori e posaçme.

Cilësia e jetës së të rinjve, reduktohet në vizitën e kafeneve dhe përcjelljes së TV. Ashtu siç u përmend më lartë, të rinjtë pak angazhohen në forma të tjera të shoqërimit, siç janë organizatat civile dhe më pak në aktivitetet vullnetare, e gjithë kjo jetën rinore e bëjnë të jetë me cilësi të ulët. Në këtë drejtim, institucionet lokale mund të ndihmojnë përmes përgatitjes së programeve lokale nga fushëveprimet e tyre, përmes cilëve do të detektohet grupi i të rinjve specifik përmes edukimit, parandalimit etj.

Të rinjtë, pak janë të informuar për ato çështje që janë me rëndësi për rininë, gjatë kësaj të anketuarit theksojnë se vet ata nuk janë të interesuar që të vijnë deri te informacionet e nevojshme. Nga ana tjetër, institucionet lokale nuk përpiqen që përmes mediumeve dhe kanaleve të disponueshme ti informojnë të rinjtë. Më shpesh ekzistojnë qendrat kulturore rinore në nivel lokal, të cilat kanë rolin e informuesve, por të rinjtë prapë theksojnë se në komunën e tyre nevojitet që të formohen qendrat informative. Gjithashtu, të rinjtë do të munden përmes organizatave civile më mirë të edukohen dhe të njoftohen përmes fushatave dhe aktiviteteve të posaçme.

Të anketuarit, në fushën e shëndetësisë theksojnë se kanë përcaktuar mjekun amë, megjithatë shumë pak vizitojnë evenimentet edukative nga fusha e shëndetësisë. Ekziston një numër i mjaftueshëm i institucioneve shëndetësore, për trajtim të problemeve rinore, por të njëjtit nuk ofrojnë mundësi të volitshme (financiare) për qasje më të lehtë të këtyre shërbimeve për personat e rinj të pa punësuar.

**Pasqyrë e rezultateve nga anketimet sipas fushave përkatëse**

### 3. Fusha Informimi rinorë - Rezultatet

57,5% prej të anketuarve konsiderojnë se të rinjtë janë pjesërisht të informuar për atë që i tangon. Gjatë kësaj sipas 25 % të anketuarve, shkaku për këtë është fakti se të rinjtë nuk interesohen që ti fitojnë informacionet, kurse 21 % mendojnë se institucionet lokale nuk janë të interesuar që ti informojnë të rinjtë.

Të rinjtë, më shpesh deklarojnë se në komunën e tyre ekziston qendra kulturore rinore, organizatat joqeveritare dhe qendra informative rinore.

Informacionet që janë të rëndësishme për të rinjtë, sipas 40 % të anketuarve transmetohen përmes mediumeve lokale, por për 23 % si kanal i transmetimit të informacioneve për të rinjtë

janë akoma miqtë dhe farefisi. Gjatë kësaj 48 % të anketuarve konsiderojnë se të rinjtë vetëm ndonjëherë angazhohen që të fitojnë informacionet që u nevojiten ose janë plotësisht pasiv gjatë pranimit të informacioneve.

28% të anketuarve konsiderojnë se nëse vetëqeverisja lokale, formon qendër informative rinore, atëherë do të përmirësohet informimi i të rinjve, kurse 23 % prej të anketuarve konsiderojnë se informimi do të përmirësohet nëse informacionet do të transmetohen përmes mediumeve më të shikuara/dëgjuara nga rinia.
Po ashtu 41% e të anketuarve konsiderojnë se organizatat joqeveritare mund ta ngritin nivelin e informimit te të rinjtë, nëse shfrytëzojnë më shumë moduse të ndryshme për informim, kurse 29 % konsiderojnë se nevojiten fushata për edukim të rinisë se si në mënyrë më efikase të informohen.

**<u>Konkluzion:</u>** Të anketuarit konsiderojnë se të rinjtë nuk janë aktiv në masë të duhur për nga aspekti i kërkimit të informacioneve që i tangojnë të njëjtit. Po ashtu, ekziston edhe qëndrimi se institucionet lokale nuk janë të interesuara në masë të duhur që ti informojnë të rinjtë dhe se për këtë qëllim duhet të mendohet që të implementohen ide të reja dhe moduse të reja të informimit të rinisë, që janë më të pranueshme për të njëjtit. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve konsiderojnë se nëse vetëqeverisja lokale formon qendrën informative rinore, në masë të konsiderueshme do të përmirësohet informimi rinorë. Po ashtu, organizatat joqeveritare mund të ndihmojnë përmes fushatave për edukim rinorë ti informojnë të rinjtë se si në mënyrë më efikase të informohen që ti shfrytëzojnë informacionet.

**<u>Rekomandime:</u>**
- Shkollat dhe organizatat civile, të realizojnë fushatë për të rinjtë me qëllim të ngritjes së nivelit të informimit të tyre për qasje deri te informacionet e nevojshme.
- Vetëqeverisja lokale të përkrah themelimin e mediumeve rinore lokale.
- Të formohen qendra funksionale informative rinore, që do të financohen nga vetëqeverisja lokale, dhe në mënyrë të plotë do të udhëhiqen prej të rinjve.
- Vetëqeverisja lokale, në aspekt financiarë të ndihmojë botimin e gazetave dhe revistave shkollore.

### 4. Fusha Puna rinore lokale – Rezultatet
Është numri i vogël i të anketuarve që janë anëtarë në shoqatat civile ose në partitë politike. Derisa 87 % prej të anketuarve, prononcohen se nuk janë anëtarë të ndonjë shoqate civile, 77 % e të anketuarve prononcohen se nuk janë anëtarë të ndonjë partie politike, përkatësisht më e lartë është përqindja e atyre që janë anëtarë të ndonjë partie politike. Gjatë kësaj, nuk ka dallime të konsiderueshme sipas gjinisë dhe moshës për sa i përket anëtarësimit në ndonjë parti politike ose shoqatë civile. Pjesa më e madhe e të anketuarve 73 % nuk dinë se në komunën e tyre ekziston organizata rinore që kujdeset për plotësimin e nevojave rinore. prej këtu mund të konkludojmë për interesimin e vogël të anketuarve për anëtarësim në shoqatat civile. Gjatë kësaj, pothuajse në të gjitha komunat ka ndonjë i cili ka është prononcuar se në komunën e tij ekziston organizatë rinore. Gjendja e tillë, vetëm dëshmon për rezultatet sipas të cilëve 58 % prej të anketuarve prononcohen se të rinjtë në komunën e tyre, rallë herë orvaten për zgjidhjen e problemeve rinore ose në përgjithësi nuk interesohen fare (28%). Më pas, gjysma e të anketuarve, konsiderojnë se nevojiten më shumë mjete financiare për përkrahje të rinisë me qëllim të zmadhimit të iniciativave të tyre, por gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e tyre, në mesin e opsioneve thonë se nevojitet zmadhimi i informimit rinorë me qëllim të zmadhimit të iniciativave rinore.

76,5% të anketuarve konsiderojnë se në komunën e tyre nuk ndahen mjete të mjaftueshme për realizim të ideve rinore. Gjatë kësaj, vlen që të theksohet se edhe pse në të gjitha komunat dominon numri i të anketuarve që konsiderojnë se nuk ndahen mjete të mjaftueshme, prapëseprapë 22 % prej të anketuarve prononcohen se në komunën e tyre ndahen mjete të mjaftueshme, gjatë kësaj në komunën Karposh, pothuajse njësoj prononcohen për të dy opsionet.

Në pyetjen se çfarë më tepër u nevojitet të rinjve në komunë, 44,5 % prej të anketuarve prononcohen se u nevojiten vende të punës, përqindje të njëjtë kemi kur theksohen paratë dhe arsimi. Gjatë kësaj si pjesë dominuese e të rinjve të moshës 25 – 29 vjeçare e theksojnë vendin e punës si nevojë prioritare.

**Konkluzion:** Të dhënat e fituara në nivel lokal, tregojnë për faktin se të rinjtë shumë pak janë aktiv në nivel lokal në shoqatat civile, ashtu edhe në partitë politike. Pro aktiviteti i tyre për zgjidhjen e problemeve që i kanë është minimal dhe do të mund të përmirësohej nëse do të ndahen më shumë mjete për realizim të ideve rinore dhe nëse përmirësohet informimi i të rinjve. Të rinjtë janë pak të informuar për ekzistimin dhe veprimin e organizatave rinore në komunat e tyre. Të anketuarit theksojnë se nevoja për vende të punës është prioritare të të rinjtë e të gjitha komunave, më pas pasojnë nevoja për para dhe për arsim më cilësorë.

**Rekomandime:**

- Organizatat ekzistuese rinore në nivel lokal të realizojnë fushatë informatike për veprimet e tyre, misionin dhe aktivitetet në mesin e të rinjve në shkollat fillore dhe të mesme.
- Të hulumtohen mundësitë për prezantim të përbashkët të organizatave rinore deri te vetëqeverisja lokale, gjatë orvatjeve për sigurim të mjeteve më të larta financiare për realizim të ideve rinore.
- Organizatat rinore si prezantues të rinjve në nivel lokal të përpilojnë një program të përbashkët ose strategji lokale me vetëqeverisjen lokale, me qëllim të adresimit të problemeve më akute siç janë p.sh. punësimi, arsimimi dhe jeta kulturore.

### 5. Fusha Arsimi – Rezultatet

41% të anketuarve konsiderojnë në Shkup, sistemi arsimorë ofron përgatitje përkatëse dhe cilësore arsimore me qëllim të gjetjes së shpejtë të vendit të punës ose hapjes së biznesit personal. Por nga ana tjetër, 56 % e të rinjve (të anketuar) konsiderojnë se programet mësimore në shkollat e mesme profesionale janë të përmirësuar dhe 58 % e të anketuarve kanë qëndrim të njëjtë për programet mësimore në gjimnazet. Por 53 % e të anketuarve prononcohen se puna praktike nuk është e përfaqësuar në masë përkatëse në programet mësimore. Këto deklarata janë përkatëse me orvatjet që po merren në nivel qendrorë me qëllim të modernizimit të procesit mësimorë dhe avancimit të programeve mësimore përmes implementimit të lëndëve të reja dhe moduseve të reja të punës, por edhe me gjendjen kur të rinjtë si problem kryesorë gjatë gjetjes së punës e detektojnë mungesën e përvojës praktike.

70% të anketuarve konsiderojnë se kushtet në institucionet arsimore janë të mira për punë, që gjithashtu flet për orvatjet edhe në nivel qendrorë dhe në nivel lokal për avancim të infrastrukturës dhe kushteve të punës në shkollat. Ky trend vlen për të gjitha komunat në nivel të Qytetit të Shkupit. Në lidhje me çështjen që si prioritare u mungon institucioneve arsimore, pjesa më e madh e të anketuarve 41 % konsiderojnë se nevojitet furnizimi më bashkëkohorë teknik në shkollat. Por në nivel të komunave kjo nuk është si prioritare gjithkund. Kështu për

shembull në Qendër, Kisella Voda dhe në Saraj, të anketuarit konsiderojnë se si prioritare mungon kuadri mësimorë i përgatitur në mënyrë të bashkëkohore.

Në lidhje me arsimin jo formal, pjesa më e madhe e të anketuarve prononcohen se nuk kanë vijuar ndonjë lloj të formës së arsimit jo formal gjatë dy viteve të kaluara (53%), derisa 46% prononcohen se kanë vijuar. Prapëseprapë, bëhet fjalë për qëndrime të ndara në mesin e të anketuarve. Gjatë kësaj nuk mund të konstatohet ndonjë trend në deklaratat në lidhje me moshën e të anketuarve. Gati pjesa e njëjtë e të anketuarve përgjigjet se në komunën e tyre ekziston numër i mjaftueshëm i institucioneve funksionale që ofrojnë arsim jo formal, përkatësisht se të njëjtit ekzistojnë por nuk funksionojnë.

**Konkluzion:** Në suaza të fushës së Arsimit, të anketuarit u pyetën për disa aspekte kryesore të arsimit edhe atë për cilësinë e arsimit në përgjithësi, programet arsimore në shkollat profesionale dhe në gjimnazet, infrastrukturën dhe kushtet e punës, arsimin jo formal dhe praktikën përmes së cilës sistemi arsimorë u mundësohet të rinjve
Mund të sajohet konkludimi se të anketuarit, në përgjithësi konsiderojnë se mund të përmirësohet cilësia e sistemit arsimorë. Ata i respektojnë ndryshimet e realizuara të programeve mësimore, si në drejtimin profesional ashtu edhe në drejtimin e gjimnazeve, por nga ana tjetër, tërheqin vërejtjen se praktika nuk është e përfaqësuar në masë të konsiderueshme dhe se duhet të mendohet për atë se si të përmirësohet kjo gjendje.

Infrastruktura dhe kushtet e punës janë një çështje e cila marrë në përgjithësi ka një zgjidhje të mirë në nivel lokal. Ajo që duhet të përmirësohet si prioritare është sigurimi i pajisjeve më bashkëkohore teknike, edhe pse në disa komuna dominon nevoja për sigurimin e kuadrove më të përgatitura arsimore. Arsimi jo formal është një çështje për të cilën të anketuarit kanë qëndrime të ndara, që është si rezultat i përvojave të tyre por edhe i informimit të tyre. Prapëseprapë, pjesa më e madhe e të anketuarve nuk kanë vijuar ndonjë lloj të formës së arsimit jo formal gjatë dy viteve të kaluara.

**Rekomandime:**

- Vetëqeverisja lokale të ndërmarrë aktivitete me qëllim të përfshirjes më të madhe gjatë realizimit të procesit arsimorë në shkollat fillore dhe të mesme. Gjatë kësaj, mund të planifikohen edhe projekte për shkëmbim të praktikave pozitive edhe me shkollat tjera, në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të ndërmerren aktivitete dhe iniciativa me Ministrinë e arsimit dhe shkencës në drejtim të realizimit të politikave për cilësi të arsimit, përsosjes së kuadrit mësimdhënës dhe aktiviteteve të lobimit me qëllim të avancimit të furnizimit teknik.
- Qeverisja vendore dhe drejtorët e shkollave të mesme të realizojnë takime konsultuese me bashkësinë e biznesit për të hulumtuar mundësitë për përfshirjen e biznesit në praktikën mësimore nëpërmjet marrjes së praktikantëve dhe përfshirjes së biznesmenëve dhe menaxherëve me eksperiencën e tyre në realizimin e praktikës mësimore.
- Qeverisja vendore t’i përkrahë shkollat në qasjen deri te fondet ndërkombëtare dhe në bashkëpunimin e tyre me organizatat civile.

### 6. Fusha Pjesëmarrja rinore – Rezultate

Pjesëmarrja e të rinjve në sjelljen e vendimeve në shkollat e mesme sipas 65% të të anketuarve realizohet vetëm pjesërisht, sepse ata mendojnë se nxënësit e shkollave të mesme nuk arrijnë plotësisht të përfaqësojnë interesat e të rinjve dhe të mundësojnë pjesëmarrje.

73% e të anketuarave nuk dinë nëse qeverisja vendore e tyre ka mekanizma të tilla nëpërmjet të cilave sigurohet pjesëmarrja e të rinjve në sjelljen e të rinjve. Një pjesë e vogël e të anketuarve (25%) theksojnë se komuna e tyre ka ndonjë mekanizëm për pjesëmarrje, por kur përgjigjen për cilat mekanizma bëhet fjalë mund të shikohet që më shpesh ata janë mënyra joformale për konsultimin e të rinjve (tribuna, biseda dhe më rrallë anketa), dhe jo mekanizma dhe organe të vendosura.

97% e të rinjve thonë se qeverisja vendore e tyre deri tani nuk i ka konsultuar për ndonjë çështje të rëndësishme që i tangon ata. Gjithashtu 97% e të anketuarve thonë se as institucionet lokale nuk i përfshijnë dhe nuk i konsultojnë në sjelljen e vendimeve për çështje të rëndësishme për ta (p.sh. sport, kulturë etj.). Gjysma e të anketuarve thonë se më e rëndësishme është që të sigurohen mekanizma për pjesëmarrjen e të rinjve në sjelljen e vendimeve në shkollë. Interesant është fakti që një qëndrim të tillë kanë kryesisht jo vetëm ata që janë aktualisht nxënës por edhe të rinjtë nga mosha të ndryshme.

Në lidhje me atë që se çfarë mund të bëjnë të rinjtë për të siguruar përfshirje më të madhe në sjelljen e vendimeve, 41% e të anketuarve theksojnë se është e nevojshme që të rinjtë të organizohen më mirë, përderisa 31% konsiderojnë se duhet të propozohen në mënyrë aktive zgjidhje për problemet e të rinjve direkt deri te institucionet kompetente dhe qeverisja vendore.

**Konkluzion:** Në suazat e pjesëmarrjes rinore të anketuarit përgjigjen për eksperiencën e tyre në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve në sjelljen e vendimeve në disa nivele dhe atë në shkollë, në qeverisjen vendore, në institucionet lokale. Mund të arrihet në përfundimin se në nivel lokal në Shkup dhe në pjesën dërmuese të komunave në territorin e Qytetit të Shkupit nuk ekziston praktika e përfshirjes së të rinjve në sjelljen e vendimeve, dhe as nuk janë vendosur mekanizma për pjesëmarrje si për shembull këshilla rinor, komisione, këshilltarë, parlament rinor etj. Nga ana tjetër duhet të theksohet se ky është informacion që merret vetëm nga të rinjtë dhe sipas nivelit të tyre të informimit për mekanizma të tillë. Të rinjtë potencojnë se më e nevojshme është që të punohet për fuqizimin e pjesëmarrjes të të rinjve në sjelljen e vendimeve në nivel shkolle si institucione ku të rinjtë kalojnë pjesën më të madhe të kohës së tyre. Gjithashtu të anketuarit mendojnë që është e nevojshme të nxiten forma të ndryshmet të organizimit rinor me qëllim pjesëmarrjen e të rinjve në sjelljen e vendimeve në nivel lokal dhe që të rritet dhe të ketë efekt.

**Rekomandime:**

- Të realizohet edukimi për të rriturit domethënë për bartësit e funksioneve të qeverisjes vendore, shkollave dhe institucioneve të tjera lokale me qëllim informimin e tyre për mundësinë për pjesëmarrjen e të rinjve, modelet dhe format ekzistuese.
- Të realizohen fushata për edukimin e të rinjve në shkollat fillore dhe të mesme me qëllim prezantimin e të drejtës së tyre për pjesëmarrje në sjelljen e vendimeve, si dhe mënyrat dhe modelet e pjesëmarrjes në nivel lokal.
- Të shikohet mundësia për vendosjen e këshillave rinor, parlamentit të rinjve ose organe të ngjashme për konsultim me të rinjtë.
- Në shkolla të zhvillohen në mënyrë precize rregulla dhe procedura për zbatimin e zgjedhjeve shkollore, formimin e bashkësisë shkollore dhe përcaktimin e rolit të tyre.

### 7. Fusha Shëndetësi – Rezultate

Një pjesë e njëjtë e të anketuarve 46% theksojnë se në vitin e kaluar kanë kryer, përkatësisht

nuk kanë kryer vizitë preventive tek mjeku amë. Gjatë kësaj shumica e të anketuarve 87% kanë zgjedhur mjek amë. 63% e të anketuarve nuk kanë marrë pjesë në asnjë event edukativ nga fusha e shëndetit publik.

64,5% e të anketuarve theksojnë se komuna e tyre ka institucione shëndetësore të mjaftueshme të cilat mund t'u ndihmojnë në trajtimin e ndonjë problemi shëndetësor. Megjithatë 73% e të anketuarve nuk janë ndeshur me asnjë përfitim financiar në shërbimet e institucioneve shëndetësore që u ofrojnë të rinjve të papunësuar.

**<u>Konkluzion:</u>** Të rinjtë janë të ndërgjegjshëm për preventivën dhe zgjedhjen e mjekut amë, por gjithashtu shumë pak prej tyre thonë se edukohen për shëndetin e tyre rregullisht. Nga ana tjetër edhe përkundër ekzistimit të një numri të madh institucionesh shëndetësore, megjithatë ata nuk mendojnë se u përgjigjej nevojave të të rinjve me ndonjë përfitim financiar.

**<u>Rekomandime:</u>**

- Qeverisja vendore në bashkëpunim me institucione shëndetësore lokale të përgatisin plane vjetore me qëllim edukimin e të rinjve në tema të ndryshme të lidhura me shëndetin.
- Shkollat në suazat e aktiviteteve të tyre plotësuese të planifikojnë dhe realizojnë evente edukative nga fusha e shëndetësisë në bashkëpunim me organizatat rinore dhe bashkësitë e shkollave.

**8. Fusha Kualiteti i jetesës – Rezultate**

27% e të anketuarve thonë se kohën e lirë e kalojnë nëpër kafene me shoqëri dhe para televizorit, përderisa 24% thonë se kohën e lirë e kalojnë në internet. Këto rezultate dominojnë në të gjitha komunat, dhe nuk ka ndryshime të dukshme as për sa i përket përcaktimit dhe as moshës dhe gjinisë.

64% e të anketuarve thonë se deri tani nuk kanë voluntuar, por edhe përkundër numrit të madh të të rinjve që nuk kanë voluntuar megjithatë 44% e tyre konsiderojnë që është e dobishme dhe përkrahin një gjë tillë. Gjysma e të anketuarve konsiderojnë që të rinjtë duhet të organizohen nëpërmjet shoqatave të tyre dhe të kërkojnë mjete më të mëdha financiare nga institucionet kompetente me qëllim përmirësimin e kualitetit të jetesës së tyre.

**<u>Konkluzion:</u>** Edhe përkundër mundësive ekzistuese për angazhimin e shoqatave civile, vullnetarizmit, praktikës dhe anëtarësimit në parti politike, megjithatë numri më i madh i të rinjve mbeten jo aktivë, nuk janë pjesë e vullnetarizmit, nuk janë anëtarë të ndonjë partie dhe e kalojnë kohën e lirë pa kualitet. Ata më shpesh janë nëpër kafene, para TV dhe internetit. Të anketuarit mendojnë që shoqatat civile mund të kontribuojnë në rritjen e kualitetit të jetës të të rinjve në komunë nëse marrin më shumë mjete financiare për iniciativat e të rinjve.

**<u>Rekomandime:</u>**

- Shkollat të realizojnë edukimin për përparësitë e vullnetarizmit dhe të nxisin të rinjtë që të jenë pjesë e këtij vullnetarizmi gjatë kohës së tyre të lirë.
- Shoqatat civile të përgatisin programe lokale për të rinjtë vullnetarë si për shembull: programe për ndihmë për personat e moshuar, aktivitete për pastrimin e hapësirës, aksione humanitare t realizuara nga të rinjtë etj.

- Të hulumtohen mundësitë për angazhimin e të rinjve në gazeta lokale, në stacionet TV dhe radios.

**9. Fusha Punësime – Rezultate**

Edhe pse duhet të jetë dominues fakti që kualifikimet janë kryesore për punësim, megjithatë 39% e të anketuarve mendojnë që mund të punësohesh më lehtë nëse je anëtar i ndonjë partie politike, përderisa 28% mendojnë që për tu punësuar duhet të kesh miq /lidhje farefisnore.

61% e të rinjve duan të kenë punë të vazhdueshme, përderisa një numër i vogël përcaktohen për opsione të tjera për shembull punë sezonale, punë në projekte etj. Gëzon fakti që një pjesë e madhe e të anketuarve 45,5% nëse kanë mundësi të zgjedhin, do të zgjedhin që të krijojnë biznesin e tyre. Gjithashtu një e treta e të anketuarve duan të punojnë në administratën shtetërore. Në lidhje me grupet e moshave që përcaktohen për opsione të ndryshme, mund të thuhet se zgjedhja për të krijuar biznesin e tyre dominon tek të tre grupet e moshave. Si vërtetim i qëndrimit se punësimi më së shpeshti fitohet përmes anëtarësimit në parti politike ose me lidhje familjare është edhe përgjigja e pyetjes se sa shpesh të anketuarit e vizitojnë Agjencinë për punësim. 35% e atyre që janë jashtë procesit mësimor edhe kërkojnë punësim deklarojnë se asnjëherë nuk e kanë vizituar Agjencinë për punësim në 12 muajt e kaluar. Më tutje mund të thuhet se si pasojë e mospasjes së kontaktit me Agjencinë për punësim kemi edhe informimin e ulët të të anketuarve për masat për punësim që i ndërmerr Agjencia për punësim dhe Qeveria. 70% e të anketuarve përgjigjen se nuk janë të informuar me masat, ndërsa 97,5% deklarojnë se nuk kanë qenë të përfshirë si shfrytëzues të këtyre masave.

Në lidhje me përpjekjet të cilat vetëqeverisja lokale i ndërmerr për përmirësimin e gjendjes me punësimin e të rinjve, 77% e të anketuarve nuk janë të informuar se a ekziston program i veçantë në komunën e tyre për përkrahjen e punësimit të të rinjve, kurse 20% deklarojnë se nuk ekzistojnë programe të tilla në nivel lokal. Në lidhje me atë se sa institucionet arsimore bashkëpunojnë me sektorin e biznesit që të arsimojnë fuqi punëtore adekuate dhe të kërkuar, të anketuarit nuk janë të informuar sa duhet, prandaj 37% deklarojnë se nuk kanë informata të tilla, kurse 36% se bashkëpunim ekziston por vetëm ndonjëherë.

**Konkluzion:** Në lidhje me problemin që tangon më së shumti të rinjtë, punësimin, rezultatet të cilat janë fituar në nivel lokal në komuna vetëm vërtetojnë problemet e përgjithshme kombëtare. Të anketuarit potencojnë se politizimi i procesit të punësimit, përkatësisht anëtarësimi në parti politike ose me lidhje miqësore janë kyçe në gjetjen e punës. Ata janë të dekurajuar se mund të gjejnë punësim në mënyrë tjetër me kualifikimet dhe/ose përvojën e tyre, prandaj rrallë vizitojnë Agjencinë për punësim. Të anketuarit janë pak të informuar për masat të cilat Agjencia për punësim dhe Qeveria i ndërmarrin për rritjen e punësimit dhe një pjesë shumë e vogël e tyre janë përfshirë si shfrytëzues të këtyre masave. Gjithashtu personat e rinj në pjesën më të madhe nuk kanë informata për bashkëpunim mes institucioneve arsimore dhe biznesit, përkatësisht besojnë se bashkëpunimi i tillë ndodh rrallë. Ky qëndrim tregon se të anketuarit rrallë kanë pasur përvojë që të punësohen përmes ndërmjetësimit nga institucioni i tyre arsimor me ndonjë biznes. Edhe përkundër gjendjes së tillë të rinjtë deklarojnë se më së shumti do të kishin dëshirë të themelojnë biznes të tyrin dhe në këtë mënyrë të punësohen dhe gjatë kësaj si opsion më i preferuar për punësim është puna e përhershme kundrejt punës sezonale ose punës në projekte. Në fund, duhet të sjellim konkluzion se pjesëmarrja e vetëqeverisjes lokale në përmirësimin e gjendjes me punësimin e të rinjve është minimal, nuk ekzistojnë programe të veçanta për punësim në nivel lokal e as të rinjtë nuk janë të informuar sa duhet që të shfrytëzojnë masat kombëtare për përkrahje të punësimit.

**Rekomandime:**

- Vetëqeverisja lokale të vendosë bashkëpunim të rregullt me Agjencinë për punësim dhe të organizojë takim me të rinjtë me qëllim që të prezantohen masat për përkrahje të punësimit të të rinjve.
- Vetëqeverisja lokale në bashkëpunim me Agjencinë për punësim të realizojë edukim të të rinjve me qëllim prezantimin e mundësive për hapjen e biznesit individual dhe subvencionimin e punësimit.
- Agjencia për punësim të realizojë edukim për të rinjtë në bashkëpunim me shkollat që tu prezantojë të rinjve gjendjen me ofertat dhe kërkesat e profileve të punës në tregun e punës.

**10. Fusha Kulturë dhe sport – Rezultate**

Sipas 54,5% të të anketuarve të rinjtë në komunë nuk kanë mjetet të nevojshme financiare që të vizitojnë manifestime kulturore. Gjatë kësaj, 70% e të rinjve janë deklaruar se në komunën e tyre nuk ka manifestime të mjaftueshme dhe adekuate kulturore. Përjashtim nga kjo është komuna Qendër në të cilën të rinjtë konsiderojnë se ka manifestime të mjaftueshme, ndërsa në komunën Karposh gati është e barabartë pjesa e të anketuarve për të dy opsionet.

Të anketuarit të cilët u pyetën që të zgjedhin më shumë opsione se si të përmirësohet oferta kulturore në komunën e tyre i zgjedhin si top tre opsionet: ndarje e më shumë mjeteve në komunë, konsultim i të rinjve gjatë përgatitjes së programit dhe realizim i manifestimeve të reja dhe të ndryshme kulturore. 57% e të anketuarve deklarojnë se nuk merren në mënyrë aktive me ndonjë sport gjatë së cilës sipas moshës mund të konstatohet se më aktivët janë të rinjtë mes 15-19 vjet. Edhe pse jemi dëshmitarë të pasurimit të infrastrukturës sportive, ende pjesa më e madhe e të rinjve nuk merret me sport. Të anketuarit konsiderojnë se në komunën e tyre ka klube dhe aktivitete sportive por ato nuk janë të mjaftueshme. Për këtë përjashtim është komuna Aerodrom ku të rinjtë konsiderojnë se ka klube dhe aktivitete të mjaftueshme sportive, ndërsa të anketuarit nga Qendra dhe Karposhi gati njëjtë i zgjedhin të dy opsionet se ka aktivitete të mjaftueshme, përkatësisht se ka aktivitete por nuk janë të mjaftueshme. Të anketuarit konsiderojnë se këto aktivitete më së shumi i financojnë prindërit dhe vet të rinjtë.

**Konkluzion:** Të anketuarit nuk janë të kënaqur nga ofertat kulturore në komunat e tyre. Përjashtim është komuna Qendër. Ata konsiderojnë se duhet të kyçen në përgatitjen e ofertave kulturore dhe njëkohësisht se janë të nevojshme më shumë mjete financiare për manifestime kulturore. Të rinjtë gjithashtu propozojnë që të ketë lirim për vizita të manifestimeve kulturore. Në lidhje me sportin mund të thuhet se edhe përkundër përpjekjeve të mëdha për ndërtimin e infrastrukturës sportive, ende nuk ekziston shpirt sportiv i ndërtuar fuqishëm tek të rinjtë të cilit deklarojnë se në pjesën më të madhe nuk merren në mënyrë aktive me ndonjë sport. Gjithashtu, sipas njohurive të të anketuarve, është i nevojshëm angazhim edhe më i madh i shtetit në përkrahjen dhe financimin e klubeve dhe aktiviteteve sportive në nivel lokal.

**Rekomandime:**

- Vetëqeverisja lokale të kushtojë më shumë rëndësi gjatë planifikimit të manifestimeve kulturore dhe t'i involvojë të rinjtë në krijimin e kulturës lokale përmes regrutimit të ideve për evenimente kulturore rinore.
- Institucionet kulturore në nivel lokal të realizojnë aksion për vendosjen e çmimeve të privilegjuara të bilave për të rinjtë të cilit janë në proces arsimor ose janë të papunësuar.
- Shkollat të vendosin edukim plotësues për rëndësinë e sportit për zhvillim të shëndetshëm të të rinjve që të promovohen vende sportive dhe objekte të cilat mund të shfrytëzohen.

- Të realizohen manifestime sportive lokale të cilat do t'i financojë vetëqeverisja lokale dhe shteti.

## 11. PASQYRË E SHKURTËR

Koalicioni i organizatave rinore SEGA është organizatë joprofitabile e cila punon në përfaqësimin dhe lobimin për të rinjtë, zhvillimin dhe zbatimin e politikave rinore në RM dhe i lidh të rinjtë me qëllim përmirësimin e gjendjes së tyre të përgjithshme.

Në periudhën nëntor 2012 – shtator 2013 Koalicioni SEGA e implementoi projektin "Krijim i Strategjisë Lokale Rinore të Qytetit të Shkupit", të financuar nga Qyteti i Shkupit dhe Regjioni Normandia e Ulët.

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i SLR 5 vjeçare për Qytetin e Shkupit dhe Plan Aksionar 1 vjeçar për vitin 2014 përkatësisht vitin e parë rrjedhës të strategjisë.

Qëllimi i kësaj strategjie është që të përmirësohet jetesa e të rinjve në Qytetin e Shkupit përmes përfshirjes së tyre aktive në proceset në nivel lokal.

Strategjia përbëhet nga dy pjesë kyçe: strategji 5 vjeçare dhe plan aksionar 1 vjeçar. Të dy dokumentet në vete përmbajnë aktivitete lidhur me përmirësimin e jetesës së të rinjve të shprehura në 8 fusha të cilat janë identifikuar si prioritare:

- Informim rinor;
- Punë rinore lokale;
- Pjesëmarrje rinore;
- Arsim;
- Shëndetësi dhe parandalim;
- Kualitet të jetesës;
- Vetëpunësim rinor;
- Kulturë.

Për çdo fushë prioritare në strategji është përcaktuar qëllimi i fushës prioritare (çfarë duam të arrijmë në atë fushë), qëllimet specifike për fushën prioritare (çfarë do të bëjmë që të arrijmë deri te qëllimi kryesor) dhe strategji për arritjen e qëllimeve specifike (në cilën mënyrë do të realizojmë qëllimet specifike). Në PA janë paraqitur aktivitetet konkrete të cilat duhet të ndërmerren në pjesën e fushave prioritare në vitin e parë të implementimit të SLR.

Strategjia dhe plani aksionar si dhe analizat e nevojave janë përgatitur në bazë të realizimit të një sërë aktiviteteve ku drejtpërdrejt janë kyçur të gjitha grupet të cilat janë relevante në procesin e përgatitjes së SLR (përfaqësues nga institucione lokale, Qyteti i Shkupit, organizata civile, të rinj të përkatësive të ndryshme etnike dhe të moshave të ndryshme) me qëllim që të pasqyrohen nevojat reale të të rinjve nga Qyteti i Shkupit.

## 12. QËLLIMI I STRATEGJISË

Të përmirësohet gjendja e përgjithshme e jetesës së të rinjve në Qytetin e Shkupit.

## 13. PRIORITETE
## a. PRIORITETI INFORMIM RINOR

**Qëllimi i përgjithshëm**
Vendosja e mekanizmave (ose kanaleve) për informim të të rinjve në nivel të Qytetit të Shkupit.

**Qëllimi specifik 1**
Forcim i bashkëpunimit mes vetëqeverisjes lokale, organizatave lokale dhe subjekteve tjera juridike që zhvillojnë programe për të rinj.

**Strategjia**
1.1. Ndërthurje e të gjitha palëve të interesuara.
1.2. Infoqendër rinore e vendosur dhe funksionale.
1.3. Kanal funksional për informim, bazë e të dhënave.

**Qëllimi specifik 2**
Të shfrytëzohet interneti dhe teknologjia mobile si vegël për informim rinor.

**Strategjia**
2.1. Krijim i aplikacioneve për smart aparate, për shkëmbim informacionesh në dobi të të rinjve.
2.2. Pjesë kryesore, në kornizë të Informatorit ekzistues të Qytetit të Shkupit.
2.3. Shfrytëzim i potencialit të rrjeteve sociale në procesin e informimit.

**Qëllimi specifik 3**
Të përpunohet, zhvillohet dhe realizohet plan komunikimi i Qytetit të Shkupit, me qëllim arritjen e informacioneve deri tek të rinjtë.

**Strategjia**
3.1. Plane të përpunuara veçantë për mediumet e internetit dhe radios dhe TV mediumet.
3.2. Komunikim i drejtpërdrejt dhe informim i të rinjve.
3.3. Realizim dhe përkrahje e fushatave.

## 5.2. PRIORITETI PUNË RINORE LOKALE
**Qëllimi i përgjithshëm**
Rritja e bashkëpunimit dhe informimit mes komunave, shkollave, shoqatave civile dhe të rinjve në drejtim të nxitjes së vullnetarizmit te të rinjtë dhe rritje të kyçjes së të rinjve në realizimin e projekteve dhe programeve të drejtuara në punësimin dhe përmirësimin e programeve mësimore.

**Qëllimi specifik 1**
Rritje e informimit të të rinjve në lidhje me ligjin për vullnetarizëm dhe përfitimet nga puna rinore informim për shoqatat civile të cilat veprojnë në fushën e plotësimit të nevojave të të rinjve dhe aktivitetet e vazhdueshme të cilat i realizon qyteti i Shkupit, komunat, shoqatat rinore të qytetarëve, shkollat dhe organizatat studentore në drejtim të projekteve rinore.

**Strategjia**
1.1. Edukim i të rinjve në shkolla për kornizën ligjore dhe përfitimet nga vullnetarizmi.
1.2. Organizim i fushatave publike për promovimin e vullnetarizmit.
1.3. Zhvillim i bashkëpunimit me shoqata civile të cilat punojnë në këtë sferë.

1.4. Hapje e internet portalit informativ rinor.
1.5. Nxitje e të rinjve për hapjen e shoqatave civile.

**Qëllimi specifik 2**
